



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Korçë më 12.12.2025

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë **z.Sotirag Filo**

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotirag Filo, se ditën **e enjte, datë 18 dhjetor 2025, ora 12⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53,pika 4 si dhe bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 , neni 63, neni 64 me rend dite si më poshtë:

- 1- “PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS”.
- 2- “PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 27 NËNTOR 2025”.
- 3- “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-30 NËNTOR 2025”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Anxhela Tahoe , znj.Edlira Mitre , znj.Ornela Alikaj, z.Erjon Kurti, znj.Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj.Laureta Alidinaj.

- 4- “MBI MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Anxhela Taho , znj.Edlira Mitre , znj.Ornela Alikaj, z.Erjon Kurti, znj.Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj.Laureta Alidinaj.

- 5- “MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Anxhela Taho , znj.Edlira Mitre , znj.Ornela Alikaj, z.Erjon Kurti, znj.Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj.Laureta Alidinaj.

- 6- “PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE”.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj.Ada Përmeti, z.Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj.Alketa Zheku.

(Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes) z.Llambert Malaveci, z.Erjols Haxhillari, znj.Anxhela Taho, z.Klajdi Pllaha dhe znj.Alketa Zheku.

- 7- SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj.Ada Përmeti, z.Petrika Tollkuçi, znj.Mirela Qeleshi, znj.Alketa Zheku.

- 8- INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTIVEVE AFATGJATA, AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË KLUBIT SHUMËSPORTËSH PËR PËRIUDHËN JANAR-GUSHT 2025.

- 9- PIKA TË NDRYSHME.

- 10- KËRKESA-ANKESA TË QYTETARËVE.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e hënë, datë 15.12.2025 , ora 11⁰⁰

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qelesi, znj. Alketa Zheku ditën e hënë 15.12.2025, ora 12⁰⁰**

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 27 NËNTOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak rendi i ditës është shpërndarë, kush është dakort?

Këshilltar E.Bregu: Kam diçka për të thënë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Këshilltar E.Bregu: Tek rendi i ditës nuk shoh dy pika që duhet të ishin, pika e parë është ngritja e komisionit për verifikimin e apartamenteve dhe banesave sociale dhe pika tjetër që unë nuk e shoh tek rendi i ditës për përfundimin e procedurës për emërimin e anëtarëve në komisionet përkatëse. Për këtë doja të pyesja janë në rend dite të parashikuara apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Janë të parashikuara tek pikat e ndryshme, atje e kemi parë të arsyeshme që do diskutohen, unë do e thoja edhe më pas kryetarët e grupeve janë takuar edhe në kryesi kemi rënë dakort për ndryshim, por kur të vijë momenti në të ndryshme do e trajtojmë.

Kush është dakort me rendin e ditës, ju lutem këshilltarëve të votojnë?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 30 TETOR 2025 DHE DATËS 11 NËNTOR 2025”.

Këshilltar L.Petri: Megjithëse nuk isha mbledhjen e zhvilluar në datën 11 nëntor vë re nga procesverbali i shpërndarë se nga 25 këshilltarë pjesëmarrës dhe për të vetmen çështje që u mor në shqyrtim kanë qënë pro 27.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Në momentin e hapjes të mbledhjes kanë qënë 25 këshilltarë dhe gjatë zhvillimit të mbledhjes kanë erdhur edhe dy këshilltarë të tjerë, ne në momentin e parë themi se janë x këshilltarë gjatë mbledhjes mund të shtohen ose ikin këshilltarë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 TETOR 2025”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare J.Romaçka: Komisioni u mbledh shqyrtoi materialin dhe rezultoi që nga 6 % i fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike janë përfituese 54 familje nga po ky fond si kompensim i energjisë elektrike 22 familje dhe nga fondi i buxhetit vendor përfitojnë 9 familje. Materiali u shqyrtua ishte i plotë dhe komisioni vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me çështjen në fjalë pavarisht se është komfort ligjit, shifrat që u shpërndahen banorëve si ndihmë ekonomike janë në nivel qesharak dhe e kemi diskutuar edhe herë të tjera dhe na është premtuar nga ana e Bashkisë se kjo do diskutohet në nivele të larta qeverisëse, t’i kërkojnë Qeverisë, Parlamentit në formë shkresore që kjo situatë të ndryshojë pasi këto shifra nuk bëjnë të mundur funksionimin e kësaj pakete ekonomike. A mund të kemi informacion nëse është bërë ndonjë lëvizje apo jo?

Ekzekutivi A.Vranishti: Qeveria Shqiptare në muajin shtator ka bërë një indeksim për rritjen e këtyre pagesave me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave janë rritur për disa kategori të veçanta, për nënat kryefamiljare mbi 300 mijë është dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike, për kryefamiljarët e vetmuar është rritur 10 % dhe për kategorinë e viktimave dhunë në familje është rritur me 10 %. Tani Ministria ose në bazë të sistemit të pikëzimit nëse do ketë rritje.

Këshilltar E.Bregu: E theksova se këto shifra janë në nivel qesharak dhe rritja 10 % nuk përbën asnjë lloj sensi apo ndikimi nuk përbën asgjë reale tek ajo ndihma që ne jepim tek këto familje dhe ajo që ne kemi diskutuar këtu në Këshill nuk është rritja në këtë lloj forme por indeksimi dhe përshtatja sipas nevojave duke pasur parasysh koston e jetesës në Shqipëri, kjo është çështja. Nuk është çështja janë marrë masa apo janë bërë ristaurime, pyetja ime kishte të bënte tek kjo pikë jo tek ajo që ju na kthyer përgjigje, prandaj ju drejtova më shumë Kryetarit të Bashkisë sepse ai është titullari edhe ka kompetenca për të ndërhyrë tek çështje të tilla.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera nga këshilltarët?

Këshilltare A.Përmeti: Dua të bëj vetëm një saktësim duke u konsultuar edhe me listën, normalisht kompensimi unë e shoh që është rritur sepse shohim që shkojnë edhe në vlerën 7 mijë e ca lekë, apo 8 mijë e ca lekë në varësi se çfarë pozicioni ka ai që aplikon, numri i anëtarëve dhe kush ka kompensim apo jo energjie. Vlera më e ulët që shoh këtu është 200 e ca lekë dhe vlera më e lartë 8 mijë e 700 lekë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka koment në lidhje me këtë, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“MBI PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË HARTIMIN E PROJEKT- RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE MASAT NË RASTET E MOSBANIMIT OSE MOSSHFRYTËZIMIT PËR BANIM”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare J.Romaçka: Në lidhje me këtë temë bëhet fjalë për një ide që është hedhur dhe mbështetur nga gjithë anëtarët e Këshillit tek mbledhjet e tjera, për ngritjen e një grupi pune ndërsektorial për të ndjekur ose rregulluar situatat që nuk janë parashikuar drejt për drejt në ligjin e strehimit social. Bëhet fjalë për ngritjen e një grupi pune të përfaqësuar nga drejtoria e strehimit social, drejtoria juridike dhe Këshilli Bashkiak i cili do përfaqësohet minimalisht nga tre persona, të gjithë e përkrahëm si ide, vetëm një shtesë të vogël, tek përfaqësimi i Këshillit Bashkiak minimalisht janë tre persona dhe ne propozuam

të jetë një përfaqësues i komisionit të ligjeve, një i çështjeve sociale dhe dikush nga ndonjë komision tjetër, gjithsesi është i mirëpritur çdo kush tjetër që ka qejf të kontribojë.

Këshilltare A.Përmeti: Me këtë kërkesë që ka erdhur në fillimim thuhet se është relacion shpejgues, pastaj më pas përfaqësim dhe në fund kërkesë që Këshilli Bashkiak të bëjë pjesë tek kjo grup pune. Duke qënë se si çështje e kemi ngritur disa herë, unë bazuar dhe tek kjo kërkesë kam lexuar edhe ligjin dhe çfare ligji merr parasysh në pikat ku ky komision apo grup pune do ndërmarrë veprimtarinë e tij. Realisht Bashkia e ka një ent menaxhues që është drejtoria e strehimit social dhe menaxhimi i banesave sociale. Pse kërkesa ka erdhur pa firmën e drejtorisë juridike si çdo shkresë tjetër që vjen në Këshill?

A ka konflikt interesi që Këshilli Bashkiak të jetë duke qënë se ai është kontrollues dhe vendimmarrës, në lidhje me atë ç'ka atij i sillet në Këshillin Bashkiak?

A e ka të përfshirë ligji në lidhje ku ndërpritet kontrata sipas neneve përkatëse dhe pse janë cilësuar sa anëtarë duhet të ketë nga Këshilli Bashkiak dhe nuk ka të cilësuar se kush e përfaqëson dretjorinë e strehimit apo atë juridike? Duhet të jetë e cilësuar.

Pse nuk përfshihet roli i komisionit të strehimit sepse është shumë e rëndësishme?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përgjigjet nga drejtoritë përkatëse.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Në lidhje me pyetjen se çfarë përfaqëson ligji për prishjen e kontratës, ai nen i veçantë është përshirë në kontratë. Detyra që na doli nga Këshilli në datën 25 shtator ishte arritja në përfundimin sesi do rregullojmë situata që nuk parashikohen në ligj, siç është rasti kur familjarët paguajnë rregullisht qiranë por nëpërmjet rregullimit pa konsum, ne arrijmë në një përfundim që banesa nuk po shfrytëzohet për banim. Në zbatim të asaj detyrë ne përgatitëm një relacion ku kërkohet përfshirja në grupin e punës që do hartojë rregulloren. Në lidhje me përfaqësuesit që do ketë secila drejtori, unë mendoj se drejtoria e strehimit social do përfshihet e gjitha sipas strukturës drejtori, përfaqësues, ndërsa për drejtorinë juridike besoj se do kemi emërtesa nga kjo drejtori. Në lidhje me komisionin e strehimit, nuk e kemi parashikuar përse kohë komisioni i strehimit merret kryesisht me sistemin e përzgjedhjes të përfituesve jo me çështjen e administrimit të banesave.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka kërkuar fjalën kryetari.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këtë pikë po e diskutojmë në vijim të shumë diskutimeve që kemi bërë këtu në Këshill edhe me kërkesën e minimalisht të një qytetareje që ka ngritur pretendimin se ka 1 ose disa banesa të ndërtuara nëpërmjet qirasë sociale të cilat nuk përdoren nga familje që i kanë përfituar me vendim Këshilli, pra ky ka qënë historiku dhe është lënë në mbledhjen e fundit që do i hyjmë kësaj pune të verifikimit dhe penalizimit të atyre familjeve që ndodhen në këtë pozitë. Me materialin e sotëm përpigemi të vendosim ato rregullat në lidhje me strukturat që do merren me këtë verifikim dhe mënyra si do procedojnë. Unë mendoj Anxhela dhe ma korrigjo, e para duhet të kemi një vendimmarrje në Këshill nëse do i hyjmë kësaj procedure apo jo, pastaj duhet caktuar kryetari që me një urdhër të ngrejë grupin e punës dhe në këtë urdhër duhet të jenë të përcaktuara se cilat drejtori të Bashkisë do përfaqësohen edhe minimalisht 3 anëtarë të Këshillit të cilët duhet të na i japë Këshilli, pastaj ky grup dhe me kaq mbyllet vendimmarrja e parë. Ky grup pune duhet të punojë pastaj dhe të bëjë metodologjinë e shqyrtimit të këtyre materialeve. Cili është propozimi ynë?

Drejtroia Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare A.Përmeti: Nuk është kështu këtu.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Kryetare mundem të sqaroj diçka?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: I gjithë rendi i ditës paraprakisht ka kaluar tek kryesia, e ka parë edhe këtë material dhe ka vendosur që edhe ky material të hyjë në mbledhjen e Këshillit madje ka bërë dhe propozimet e emrave dhe nga pozita dhe nga opozita, pra kryesia ka vendosur që ky material të kalojë dhe në bazë të emrave që do miratohen sot do zbardhim edhe vendimin.

Këshilltare J.Romaçka: Diçka doja të saktësoja, nuk është varianti përfundim i kësaj pike, është thjesht një projekt rregullore të cilin ne si parim e mbështesim apo jo dhe në momentin që e mbështesim kalon në fazat shteruese. Është ide që e hodhëm dhe e mbështetëm të gjithë në 25 shtator edhe tani e kemi sjellë në variantin e projekt rregullores. A jemi gjithë dakort që për problematikat që dalin nga rasti në rast në lidhje me strehimin, të ngremë një grup ndërmjetës midis pasurisë të Bashkisë që ne e përfaqësojmë edhe personave të cilët përfitojnë, ne si komision jemi të gjithë dakort.

Këshilltare A.Përmeti: Nuk mora një përgjigje nëse ne si Këshill kemi konflikt interesi apo jo. Unë nuk jam kundër kësaj por duhet t'i bëjmë gjërat siç duhet mos na kthehen mbrapsht dhe ndërkohë ne si Këshill miratojmë rregulloren për funksionimin e Entit Menaxhues për kontrollin mbikëqyrës të këtij të fundit. Nëqoftëse ky ent nuk ka një rregullore të tijën në vetvete atëherë po, dakort. Kemi konflikt apo jo?

E treta këtu janë të parashikuara me ligj kur zgjidhet kontrata dhe nëse kjo është e cilësuar, çfarë është ndryshe që nuk është parashikuar?

Dua të jem e qartë për këto gjëra para se ne ta miratojmë.

Këshilltare J.Romaçka: Prandaj ngritja e këtij grupi do ketë në përbërje një jurist që do dijë t'i shpjegojë shumë mirë pikëpyetjet e tua. Pjesa përfaqësuese e komisionit të strehimit por ne nuk do ndërhyjmë tek rregullorja dhe ligji i Entit, thjesht do jemi pikë mbështetëse asnjë ndërhyrje në ligj apo rregullorja e entit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtoria Juridike mund të merrni fjalën për të sqaruar edhe njëherë këshilltarët para procesit të votimit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Këshilli do jetë thjesht konsulet për hartimin e rregullores ndërkohë që të gjithë detyrat se çfarë do bëhet më pas do përcaktohen në rregullore, nuk po propozojmë miratimin e rregullores. Propozimi është ngritja e një komisioni të përbashkët nga Bashkia por edhe njëkohësisht nga Këshilli për hartimin e një rregullorje në bazë të secilës mund të parashikojmë zgjidhje të tjera në bazë të kontratës përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj, kjo është ajo që po kërkojmë nuk është ajo rregullorja që përmende në bazë të ligjit, është gabim. Nëse e do edhe me shkrim patjetër pasi ta miratojmë relacionin do konfigurohet sipas vendimmarrjes. Kërkojmë thjesht të kemi 3 përfaqësues nga Këshilli tek ky komision i cili do miratojë rregulloren që do shqyrtojë raste të tjera të zgjidhjes të kontratës përveç atyre të parashikuara në ligj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjalën e ka kërkuar z.Bregu.

Këshilltar E.Bregu: Nga diskutimet e deri tanishme për ngritjen e komisionit po kuptojmë që këtu bëhet fjalë që do ngrihet një komision që do ndryshojë rregulloren, pavarësisht se kush janë pjesëmarrës nga Këshilli apo specialistë të Bashkisë, qëllimi i këtij komisioni mesa po kuptojmë është hartimi i rregullores,

ndërkohë që ne deri në seancën e kaluar kemi diskutuar për një komision të Këshillit Bashkiak për verifikimin e rasteve jo të 1 rasti bazuar në rregulloren që ekziston dhe nëse kjo rregullore që ekziston ka nevojë për një komision shtesë, mund të bëhet edhe një komision që na ka erdhur sot me propozim, nuk e kundërshtojmë këtë por thelbi i çështjes është se është kërkuar një komision nga Këshilli i Bashkisë për verifikimin. Ndoshta është e nevojshme të ngremë dy komisione?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani është ngritur një pretendim nga një qytetare se një nga familjet që ka përfituar apartament nga enti i banesave sociale dhe nuk banon atje për kohë të gjatë dhe për këtë rast nuk ka gjë të përcaktuar ligji, ai thjesht ka rastet se kur ndërpritet kontrata kur nuk paguan qiranë, kur e jep me qira tek të tjerë. Ky rast që një familje ta përfitojë dhe mos banojë atje për një kohë të gjatë nuk e ka ligji të përcaktuar. Ne e kemi gjykuar që këto raste të parashikohen në rregullore, prandaj do ngrihet ky grupi përtej përcaktimeve që ka ligji të shtojmë edhe një pikë tjetër, rastin në fjalë ajo familje e humb të drejtën për të pasur një apartament edhe këto ndryshime të reflektohen pasi të bëhet kjo rregullore të reflektohet edhe tek kontrata që ne kemi me këto familje. Duhet të ngrihet një grup pune, t'ja vemë emrin si të duam që të parashikojë këtë rast si shtesë të rregullores aktuale, në këtë komision, kemi kuptuar mbledhjet e fundit se kishit interes edhe ju si Këshill që të përfshihet, në rast se keni këtë interes na jepni emrat t'i përfshijmë, në rast se nuk keni do e ngremë këtë grup pune vetëm me punojës nga Bashkia, do bëjmë draft rregulloren dhe do e sjellim në Këshill dhe në momentin që kjo do miratohet do bëhen edhe amandime e kontratave ekzistuese pastaj do hyjmë tek pjesa e verifikimit ku përsëri jemi të hapur ta bëjmë ose me strukturat e Bashkisë ose në rast se e gjykoni se duhet të përfshihen edhe ju me përfaqësuesit tuaj, përfshihuni edhe ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit znj.Romaçka ka kërkuar fjalën.

Këshilltar E.Bregu: Një sekondë se nuk kam mbaruar diskutimin. Unë e thashë që ndoshta është e nevojshme të ngrihen dy komisione, askush nuk po ju pengon ju të ngrini këtë komision por deri në seancën e kaluar ne kemi pasur diskutimin e ngritjes të 1 komisioni verifikimi mbi bazën e legjislacionit aktual.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e ngreme dot komisionin e dytë sepse e para nuk e kemi përcaktuar sesi do bëhen verifikimet, do bëhet mbi faturat e energjisë apo të ujit, nuk e dimë.

Këshilltar E.Bregu: Këto rregulloret e verifikimit, komisioni që do bëjë verifikimin këtë rregullore do e hartojë vetë, do bëjmë këtë rregullore do ta hartojmë, do ta vemë në ekzekutim dhe do ja sjellim relacionin Këshillit për ta shqyrtuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po si do bëjë rregullore vetë, me mendjen e tij?

Këshilltar E.Bregu: Këshilli ka të drejtë të ngrejë një komision të përkohshëm për një çështje x dhe mbi këtë çështje ka të drejtë të hartojë rregulloren sesi do funksionojë ky komision.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Çfarë të keqe ka, se po diskutojmë kot për këtë çështje.

Këshilltar E.Bregu: Në rastin konkret e keqja është sepse duke ngritur këtë komision për hartimin do na marrë edhe 1 ditë kohë hartimi, pastaj do kalojmë tek komisioni i verifikimit ndërkohë që situata nuk është e tillë ku ne mund të presim sa të duam.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po çfarë do verifikojë pra tani, vajti si do e verifikojë?

Këshilltar E.Bregu: Në bazë të shqetësimit të qytetarëve, ashtu si ne e kemi diskutuar do verifikojë nëse këto banesa janë të lëshuara me qira. Kjo shkenca e madhe që bëni ju me këtë projekt ligj ku ai nuk banon 6 muaj se është i sëmure apo sepse ka ikur emigrant edhe ne do ja heqim banesën kjo mund të jetë edhe anti kushtetuese dhe kjo rregullore që ju po hartoni mund të mos pranohet dhe mund të mos vihet në funksionim asnjëherë, ndërkohë ne mund ta vemë në ekzekutiv menjëherë rregulloren aktuale dhe ky komision të punojë me rregulloren aktuale, pastaj kur të bëni shkencën e re ju me rregulloret e reja.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po me këtë rregullore janë bërë verifikimet.

Këshilltar E.Bregu:: Jo nuk janë bërë verifikimet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Janë bërë verifikimet sepse ka vajtur komisioni.

Këshilltar E.Bregu: Të jeni më konkretë e më të saktë në atë ç'ka po diskutojmë.

Këshilltare J.Romaçka: (Nuk ka audio.)

Këshilltar E.Bregu: Nuk më intereson mendimi tend.

Këshilltare J.Romaçka: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Znj.Romaçka ju lutem sepse po bëhet shumë zhurmë dhe nuk po marrim vesh se çfarë bëhet.

Këshilltar E.Bregu: Përmirësoheni sa herë të kesh dëshirë ti apo ekzekutivi mund ta përmirësojë aktualisht çështja është ngritur për komisionin e verifikimit dhe kërkojmë të fokusohemi tek kjo pikë për këtë komision, komisione të tjera ngrini sa të keni dëshirë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kemi një bazë ligjore që i penalizon ata përfituesit e banesave sociale me qira, kur e japim me qira në të tretë dhe kur nuk paguajnë. Si e bëjmë këtë verifikimin Mirela?

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky verifikim bëhet në momentin e kontartës, po mund të ngrihet një komision që tani që të verifikojë edhe njëherë gjëndjen e tyre në raport me këto dy penalizime që i ka ligji. Ndërkohë që pretendimi i zonjës që u bë edhe shkak për këtë ishte që ka individë apo familje që i kanë marrë këto apartamente mund të jenë të rregullt me pagesat, mund të mos i kenë lëshuar në të tretë por nuk banojnë atje, ky rast po them nuk është i rregulluar në ligj dhe për këtë do ngremë një grup ne si Bashki dhe po të keni interes na i thoni, të përfshihen edhe anëtarë nga Këshilli, në rast se nuk keni interes mos u përfshini, ne do bëjmë vetë një draft të ndryshimit të rregullores do e sjellim këtu, si ta vendosni ashtu do e miratojmë. Për këto dy raste e tjera në rast se vendosni që duhet të ngrihet një komision i Bashkisë që të verifikojë se mos janë lëshuar në të tretë, apo ka qira pa paguar mund ta ngrini.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Petri ka kërkuar fjalën.

Këshilltar L.Petri: Zonja Kryetare unë jap pëlqimin tim edhe dal vullnetar që në këtë grup pune që po ngrihet të jap kontributin tim se ku “pikon” çatia e banesave sociale me qira dhe për të dalë në një konkluzion për masat që duhet të merren për ata që nuk zbatojnë rregullat, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do doja një përmbledhje edhe nga z.Tollkuçi për diskutimin që ka bërë edhe me kryetarin e grupit opozitar në lidhje me përcaktimin e personave që do jenë pjesë në hartimin e kësaj rregullore. Unë do doja meqënëse z.Petri është vetëofruar për të qënë pjesë ta shikoni dhe ju mundësinë e ndryshimit për veç propozimit që ka bërë opozita.

Këshilltar P.Tollkuçi: Përshëndetje znj.kryetare, përshëndetje të nderuar kolegë ne e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kryesisë dhe nga ana e opozitës është propozuar z.Kristi, kështu që dakort duhet të shohim pjesën tjetër. Thamë se komisioni duhet të jetë me tre veta, 2 emra nga ana jonë megjithatë këtë pjesë do e shohim dhe e diskutojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar P.Tollkuçi: Propozimet tona janë znj.Edlira Mitre dhe znj.Ana Verushi.

Këshilltar E.Bregu: Kush e ka propozuar nga opozita z.Koçibelli?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetari i grupit të këshilltarëve të djathtë, sot mungon z.Devi Osmani. Meqënëse z.Lazjon është vetëofruar, propozoj që znj.Edlira, z.Koçibelli dhe z.Petri të jenë pjesë e këtij komisioni. Kush është dakort në lidhje me këtë?

Këshilltar E.Bregu: Duhet të saktësojmë sa veta do jenë në komision.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tre veta është minimum.

Këshilltar E.Bregu: Mund të bëhen më shumë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po mjaft janë. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 2 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.57 DATË 26.06.2025, “MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMIJET E PASTREHA”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare J.Romaçka: Bëhet fjalë për një ndryshim date 26.06.2025 lidhur me familjen Osmanllari e cila deri muajin e kaluar mbështetej me bonus qiraje por së fundmi niveli i të ardhurave të kësaj familje ka ndryshuar nga 22 mijë e 346 lekë në 50 mijë e 222 lekë, si rrjedhim i këtij ndryshimi dhe bonusi i përfitimit do ndryshojë nga 11 mijë e 648 lekë bëhet 7 mijë e 467 lekë mujor dhe në vlerë e 4 muajve 46 mijë e 592 lekë që përfitonte kalon në 21 mijë e 867 lekë, i gjithë efekti është i vlefshëm deri në 31

dhjetor 2025. Ndryshimi i vetëm ishte që kjo familje përfitonte një vlerë më të madhe të bonusit të qirasë si rrjedhim i të ardhurave minimaliste të themi, tani që të ardhurat e saj janë më shumë se dyfishuar vlera e subvencionit bie, ky është i vetmi ndryshim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

**“MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare J.Romaçka: Edhe këtu bëhet fjalë për një ndryshim, sygjerim më saktë që ne e gjykuam shumë normal dhe të justifikoheshëm, bëhet fjalë për katër familje shtesë që përfitojnë nga subvencioni që kanë plotësuar dokumentacionin gjatë mbledhjes të tij. Lista e përfituesve ka kaluar po këto 4 familje kanë plotësuar dokumentat e tyre në këtë kohë, ne e gjykojmë si të drejtë që me listën aktuale të shtohen edhe këto 4 familje.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Dua të sqaroj diçka në momentin që ne u mbledhëm në komision diskutuam disa aplikantë të cilët ishin në përpjekje për t'i plotësuar dokumentat që i mungon, sot nuk rezultojnë 4 por rezulton vetëm një, kështu që propozojmë që lista nga 8 aplikantë të shkojnë në 9 nëse bini dakort, të kursejmë kohë dhe kjo familje të kryejë procedurat me bankën.

Këshilltare A.Përmeti: Vetëm të cilësojë për transparencë emrin e fituesit që të jemi në rregull.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Emri i përfituesit është Stela Arben Elmaz një person në përbërje familjare, aplikon për një gazoniere, është komunitet egjiptian e punësuar në privat, të ardhurat që ka janë në kufijtë e nivelit maksimal, ka plotësuar gjithë dokumentacionin dhe për këtë arsye propozojmë ta futim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERISTAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit të financave dhe më pas ai i arsimit, kush e do fjalën?

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim bursat e nxënësve të arsimit parauniveristar 2025-2026, në institucionet arsimore publike bashkëngjitur ka dërguar dhe listën e shkollave të detajuar dhe nxënësit përfitues, ku numri i tyre është 320 nga të cilët 280 do mbulohen me fondet e Ministrisë të Arsimit dhe 40 kuota nga Bashkia Korçë. Vlera që i takon Ministrisë të Arsimit 18 milion e 447 mijë e 888 lekë dhe kontributi i Bashkisë është 2 milion e 6634 mijë e 984 lekë. Në komision u diskutuar dhe për shtimin e kuotave pasi është relativisht i ulët dhe në krahasim me vitet e shkuara, është diskutuar dhe na ekzekutivi na është thënë i është kërkuar Ministrisë të Arsimit rritja e numrit të kuotave dhe komisioni e miratoi me 4 vota pro.

Këshilltar Ll.Malaveci: Përshëndetje edhe komisioni i arsmiit u mbledh ditën e martë shqyrtoi materialin edhe nga Ndërmarrja Mbështetëse e Arsmiit dhe Çerdhes për miratimin e bursave materiali ishte i plotë vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare A.Zheku: Edhe pse isha edhe në komision më mbeti pa sqaruar një pyetje dhe tani po ja drejtoj kryetarit. Vitin e kaluar ishin një numër më i madh përfituesish nga Ministria e Arsmiit 350 dhe këtë vit ka rënë ky numër në 280 dhe 40 nga Bashkia. Ajo që mora përgjigje nga ekzekutivi është se si aplikant kanë qënë 700 nga të cilët 500 plotësojnë kriteret, prandaj 320 të përzgjedhurit përfitojnë. 180 të tjerë janë përfitues?

Plotësojnë kriteret por sipas listës të kohës të dorëzimit të dokumentacionit janë në pritje, i është bërë kërkesë Ministrisë të Arsimit për tu plotësuar edhe kjo shifër por nëse përgjigje do jetë negative, a jemi ne të gatshëm z.Kryetar për t’i plotësuar këto 180 meqnëse kemi edhe një rritje prej 100 nxënësish, rritje e plotësimit të kriterëve nga 400 që kishim vjet kemi 500. A do i mbështesim ne këta 180?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me bursat e nxënësve kemi pasur edhe një diskutim të gjatë me komisionerin e mbrojtjes nga diskriminimi, specifikisht për rastin e bursave duke u nisur edhe nga situatat që jemi gjendur vitin e kaluar, ku numri i aplikantëve ka qënë më i madh se numri i kontigjenit të buxhetit që kemi pasur në dispozicion. Së bashku me komisionerin ne kemi përcaktuar edhe mënyrën si duhet të vepronte Bashkia në këtë rast. Këtë mënyrë veprimi edhe e kemi sanksionuar në vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë dhe në njoftimet respektive që ju kemi bërë gjithë shkollave për nji ftuar familjet për aplikimin e bursave të nxënësve. Mënyra që jemi dakortësuar ka qënë e para duhet t’i drejtoheshim me një shkresë Ministrisë të Arsmiit ku t’i kërkonim rritje e numrit të bursave për vitin e ardhshëm dhe në këtë gjë e kemi bërë lidhur me aplikimet e vitit të kaluar kemi kërkuar rritjen e aplikimit të bursave. E dyta na është kërkuar nga komisioneri të bëhej një lehtësim do e quaja e

procedurës të pranimit të dokumentacionit për familjet. Atë lloj dokumentacioni që Bashkia mund ta gjente vetë, ne mos ja u kërkonim familjeve na është kërkuar nga komisioneri që duhet të përcaktojme në rast se duhet t'i paraprinim situatës ku kontigjenti i bursave të ishte më i vogël se numri i aplikimeve duke përcaktuar edhe rradhën e shqyrtimit dhe përfitimit të bursave dhe në dakortësim me komisionerin ka qënë edhe kronologjia e kohës, momenti se kur është dorëzuar aplikimi. Këtë gjë ja u kemi bërë me dije edhe në dijeninë tonë kjo gjë është bërë dhe dokumentacionin që kemi pranuar nga gjitha shkollat e kemi marrë pikërisht në këtë formë me datën edhe dorëzimin e dokumentacionit. Na është kërkuar gjithashtu nga komisionieri që Bashkia të shihte mundësinë edhe për të dhënë një numër të caktuar bursash me buxhetin e saj dhe kontigjentin që vjen nga Ministria prandaj edhe kemi alokuar 40 bursa edhe kjo është situata. Numri i bursave në total është 320, 280 nga Ministria, 80 nga Bashkia dhe renditja e përfituesve që po u sillet për miratim është sipas dakortësimit me komisionerin kundër diskriminimit. Nga komisioneri na është thënë se në rastin e Bashkisë tonë komisioneri do kryejë detyrën e tij duke i kërkuar Ministrisë të Arsmit të shohë mundësinë e plotësimit të numrit të bursave për familjet e tjera që kanë aplikuar.

Këshilltare A.Zheku: Nuk mora përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përgjigjen e more pra, numri i bursave që mund të mbështesë Bashkia me buxhetin e saj është 40 bursa.

Këshilltare A.Zheku: 180 nxënës që plotësojnë kriteret nuk janë skualifikuar sepse për 180 nxënës që po flasim janë brenda gjitha kriterëve por janë të renditur në bazë të kohës të dorëzimit jo të skualifikuarit, këta janë që plotësojnë kriteret. Të skualifikuarit janë 200 më vete, a kemi mundësi ti mbështesim edhe këta ose sa do presim ne për ta marrë në shqyrtim këtë pikë për të plotësuar këta nxënës 180 me probleme ekonomike, sociale a do e marrim në konsideratë apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal se kjo pyetje u bë edhe më parë, kryetari tha se nëse do kishte mundësi shtrese mbi vlerën 40 do e kishte thënë do të thotë kaq mundësi ka. Ne jemi në fazën që do miratojmë këtë pjesë pastaj përpjekjet do bëhen në mënyrë të vazhdueshme derisa të ketë mundësi të plotësohet deri në një numër tjetër dhe patjetër do vijnë në mbledhjet e ardhshme. Nëse nuk ka pyetje të tjera kush është dakort me këtë numër?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2027 BASHKIA KORÇË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar materialin për miratimin e kalendarit buxhetor afatmesëm 2027-2029 bashkëngjitur edhe afatet e hartimit të raporteve, miratimi i tavaneve të detajuara, komisioni vendosi t'ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar materialin për nivelin e taksave dhe tarifave vendore bashkëngjitur dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2026. Në relacion nuk ka përfshirë ndryshime në nivele tarifash apo taksash me përjashtim të disa saktësimeve dhe riformulimeve për ta bërë më të qartë nivelet e taksave dhe tarifave. Komisioni edhe këtë vendosi t'ja kalojë për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qeleshi: Një pyetje për ekzekutivin kisha. Në parashikimin e taksës që paguhet për ndërtesën dhe truallin është marrë parasysh hapësira ligjore + ose - 30 % që ka të drejtë Këshilli Bashkiak ta miratojë, domëthenë kjo taksë është në nivelin e ligjit apo është + ose -, 30 %?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje tjetër?

Këshilltar E.Bregu: Tek taksa për ndërtesë tek zëri përjashtime është edhe një zë që thotë struktura akomoduese, hotel, resort me 4 ose 5 yje sipas statusit special e të tjera. Pyetja ime është në këtë rast a ju heqim mundësinë e barazisë bizneseve të tjera sepse bizneset e tjera paguajnë taksat dhe këto jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, unë do doja një sqarim më shterues nga ekzekutivi sepse ndoshta dhe pyetjet tuaja gjejnë përgjigjet atje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani jemi në fazën e diskutimit dhe miratimit besoj të paketës fiskale të vitit 2026. Paketa Fiskale është një prej dokumentave kryesore që paraqitet për miratim nga ana e ekzekutivit dhe është baza pastaj për diskutimin dhe miratimin e buxhetit 2026. Përsa i takon paketës

fiskale ka kaluar në gjitha proceset që përcakton ligji që nga ngritja e grupit të punës, analizimi i dokumentacionit, analiza e kuadrit ligjor, konsultime me grupet e interesit edhe përgatitja e dokumentacionit final. Nga ana administrative synon thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e transparencës dhe rritjen e lehtësimit në mbledhjen e të ardhurave, siç u tha edhe nga këshilltari nuk parashikohen ndryshime në barrën fiskale por vlen të theksohen lehtësitë e parashikuara në paketën fiskale, po i kaloj të gjitha. Në këtë paketë përsa i takon taksës të pasurisë është bërë një sqarim më i detajuar i kuadrit ligjor por nuk është se ka ndryshime përsa i takon taksës të pasurisë, thjesht është parashikuar niveli që ka ligji, propozhet shtimin e dy kategorive në përjashtimin e pagesës të tarifave gjelbërim, ndriçim bazuar në planin vendor gjinor miratuar me vendim të këtij Këshilli, pra është miratuar përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2026-2027 të gjitha subjektet që do rregjistrohen nga vajza dhe gra në moshën 19-30 vjet që ushtrojnë për herë të parë në fushën e artizanatit dhe propozimi i dytë përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2026-2027 për gjithë subjektet që do rregjistrohen nga grate viktimat të dhunës në familje të cilat janë të pajisura me vendim gjykate ose udhër mbrojtje. Një propozim lidhet kjo është më tepër procedurale për mbledhjen e tarifës të parkimit, është procedurë e brendshme e Bashkisë në drejtim të tarifës të zënies të hapësirës publike, propozohen disa ndryshime në lidhje me penalitetet që propozohen për subjektet që e shfrytëzojnë këtë hapësirë, janë debitorë, propozimi i parë është që ato subjektet të cilat rezultojnë debitorë në vitet paraardhëse nuk do pajisjen me lehtësime ushtrimi aktiviteti në hapësirë publike në vitin 2026 deri në likuidimin e plotë. Propozimi i dytë lidhet me subjektet që bëhen debitorë gjatë vitit 2026 dhe nuk kryejnë pagesa brenda afateve të përcaktuara dhe nëse e kryejnë detyrimet brenda afatit do ju revoklohet leja e hapësirës publike. Përsa i takon lehtësive edhe në këtë paketë fiskale parashikohet një ulje me 20 % e tarifave vendore pastrim, gjelbërim, ndriçim për gjithë ato subjekte që kanë 20 të punësuar dhe në ulje në masën 50 % të tarifave të subjektet që kanë mbi 50 punojës të punësuar, gjitha organizatat jofitimprurëse që kanë në brendësi të tyre aktivitetin sportive do paguajnë 50 % më pak. Të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën arsimore private do paguajnë 20 % më pak në vitin 2026. Do trjatohen me tarifa të diferencuara 2109 familje kryefamiljarët e të cilëve përfitojnë vetëm pension pleqërie apo pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe kur personat në ngarkim të tyre janë të paftë për punë dhe efekti financiar i tyre është në masën 800 mijë lek të reja, këto ishin lehtësitë. Tani jemi tek përjashtimet, përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjitha subjektet që do zhvillojnë për herë të parë aktivitetin dhe rregjistrohen nga studentë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit gjatë dy viteve paraardhëse, përjashtohen të gjithë subjektet që rregjistrohen dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre për herë të parë në fushën e artizanatit, përjashtohen nga tarifa për vitin 2026 të gjitha subjektet që kanë mbi 100 të punësuar gjatë vitit paraardhës. Përjashtohen nga tarifa për vitin 2026 gjithë investitorët e huaj që do hapin apo zhvillojnë aktivitetin e tyre për herë të parë në Bashkinë Korçë, përjashtohen nga tarifa gjithë subjektet që do zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe aktivitetin e tyre në fushën arsimore private dhe ato subjekte që do zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsmimit privat plotësues dhe jo plotësues. Përjashtohen nga pagesa e tarifave gjithë komunitetet fetare të njohura me ligj dhe organizatat jofitimprurëse që kanë karakter fetar si dhe organizatat jofitimprurëse që përfaqësojnë të rinjtë dhe synojnë forcimin e tyre në shoqëri. Përjashtohen nga pagesa e tarifave gjithë fermerët pajisur me nipt fermeri, përjashtohen nga pagesa e tarifave gjithë organizatat jofitimprurëse që do ushtrojnë për herë të parë aktivitetin në Bashkinë Korçë, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore gjithë familjet jo efektive që nuk kanë pronë në Bashkinë Korçë, përjashtohen nga pagesa e tarifave gjithë familjet kryefamiljari i të cilave përfiton ndihmë ekonomike, për vitin 2025 kanë qënë 356 familje dhe vlera që kanë përfituar 21 milion lekë të vjetra, në njësitë administrative kanë qënë 311 familje me vlerë 11 milion lekë të vjetra, përjashtohen nga pagimi i tarifave gjithë familjet kryefamiljari i të cilave përfiton statusin e verbërisë për vitin 2025

kanë qënë 103 familje në qytet me vlerë të tarifave 6 milion lekë të vjetra dhe në njësitë administrative 53 familje me vlerë 2 milion lekë të vjetra. Përfshihen nga tarifa familjet kryefamiljari përfiton staturin e para dhe tetraplegjikut në qytet kanë qënë 465 familje me vlerë tarife 28 milion dhe njësitë administrative 167 familje me vlerë tarife 6 milion lekë. Përfshihen nga tarifa familjet kryefamiljari i të cilëve përfiton vetëm pension pleqërie kur familje përbëhet vetëm nga 1 pensionit, gjatë vitit 2025 kanë përfituar 2024 familje me vlerë 111 milion lekë, në njësitë administrative 410 familje me vlerë 10 milion. Përfshihen nga tarifa për zënien e hapësirës publike gjithë subjektet që e përfitojnë këtë hapësirë për muajt janar, shkurt dhe dhjetor gjatë vitit 2025 kanë qënë 43 subjekte me vlerë 17 milion, përfshihen nga pagesa e tarifës ushqimore në kopshte fëmijë të cilët vijnë nga familje të cilët janë të paaftë për punë, punëkërkues ose të papaunë. Përfshihen nga pagesa për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemit të kanalave kullues dhe mirëmbajtjes të parcelave të gjithë poseduesit e tokave buqësore në njësitë administrative malore Vithkuq, Voskopojë, Lekas. Përfshihet nga pagesa e tarifës në vizitimin e kullës panoramike personat me aftësi të kufizuar, kjo ka qënë kërkesë nga komisioneri kundër diskriminimit. Përfshihet nga pagesa e taksës për token buqësore ato toka që mbillen me kultura dyfrutore dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbledhjes, përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë gjithë taksapaguesit familjarë, përfshihen nga pagesa e taksës mbi ndërtesa, ndërtesa e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrëse me qira të pa liberalizuar, banesa sociale në pronësi të Bashkisë, pasuri e paluajtshme ndërtesë, prone e subjekteve juridike që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga këta të fundit si banesa sociale, ndërtesa që përdoren nga komunitetet fetare në funksion të aktivitetit të tyre, ndërtesat e banimit të deklaruar si vendbanim nga kryefamiljare që përfitojnë pension pleqërie ose persona që janë në ngarkim të tyre të paaftë për punë. Përfshihen nga pagesa e taksës mbi ndërtesë familjarë që trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe ndërtesat kulturore në mbrojtje të përkohëshme apo të përhershme në kohën që dekalohet mbrojtja sipas legjitlacionit në fuqi. Të gjitha këto efektet financiare të përfshirësive apo lehtësive që unë i lexova pjesa më e madhe tyre kanë një efekt financiar të llogaritur në buxhetin e Bashkisë prej 30.2 milion lekë të reja, ka dhe një seri incentivash që lidhet me një kategori të caktuar siç janë nxënësit apo persona me aftësi të kufizuara, apo studentët e pajisur me kartë student apo pensionistët të cilët nuk po i lexoj. Kjo ishte një përmbledhje e lehtësimeve apo përfshirësive që parashikon paketa fiskale, siç thashë edhe në fillim nuk ka ndryshime në rritjen e barrës fiskale për asnjë kategori që janë subjekt i kësaj pakete, kategoritë e biznesit, ju ftoj ta miratoni këtë paketë, për t'i çelur pastaj rrugën për miratimin e buxhetit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, besoj se dhe këshilltarët në pyetjet e bëra morëm përgjigje. Kush e do fjalën për diskutim?

Këshilltar L.Petri: fjalën që mbajti z.kryetar e dëgjova me vëmendje dhe i bëri një lexim tërësor paketës fiskale dhe mendoj që në gërmëme ndonjë përfshirje të vogël është pothuajse është e qëndisur sepse tashmë dukshëm është bërë përvojë e gjatë në këtë drejtim, është bërë një konsensualizim i specifikave të Bashkisë tonë në bashkëpunim me ligjin. Po ashtu është vënë dora në zemër për target grupet e veçanta. Po në frymë na lind e drejta të pyesim, si qëndron kjo paketë fiskale në frymë dhe a janë marrë në shqyrtim parametrat e popullsisë?

Ne ende sot na është ofruar nga ekzekutivi që të kenë mundësinë dhe të thonë sa është popullsia defacto dhe de jure në Bashkinë Korçë?

Po ashtu na mungon një metodë matje sesa vizitorë na vijnë mesatarisht në ditë dhe në vit në Bashkinë tonë, po ashtu natyrisht mund të pyesim se çfarë bëjmë ne me investimet e mëdha para disa vitesh u trumbetua me të madhe se mund të vinte një investitor për një fabrikë të një linje të makinave që do

prodhoheshin kablo për eksportin, ajo jo vetëm që nuk u bë po as nuk u informuan njerëzit pse nuk u bë dhe tani ne mësojmë që kjo fabrikë është çelur në Manastir jo shumë larg që këtu dhe janë punësuar 5 mijë njerëz atje dhe ka fuqi potenciale për rritje, ka dhe zyra për një fabrikë që po çelet në Shkup dhe përfytyroni sikur Bashkia jonë të kishte 5 mijë të punësuar dhe rrogat nuk janë në nivele të larta si në Danimarkë por nuk janë as si në Shqipëri kjeni parasysh. Çfarë bëjmë ne me këta investitorë potencialë dhe ku e komunikojmë?

Për mendimin tim ka vend për përmirësim në këtë drejtim se sa atraktivë bëhemi për këta investitorë dhe ka vend për përmirësim edhe për target grupe sidomos për pensionistët të cilët nuk janë të qartë se si dhe ku kanë ulje, që kanë familjarët jashtë shtetit dhe nuk e di mund të bëjmë nivele broshurash, mund të komunikohet nga kolegët e Bashkisë, por duhet bërë e theksues se në nivel teknik mund të jetë shumë mirë por në nivel komunikativ jemi shumë dobët, këto kisha unë znj.kryetare, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Diskutimi duhet kuptuar që është për paketën fiskale dhe këtu u prek u prek një pike që është paketa fiskale në raport me investitorët e huaj, në rast se ishit të vëmendshëm në raport me atë që unë thashë ne me këtë paketë fiskale i përjashtojmë investitorët e huaj të rinj nga gjithë pagesa e tarifave të Bashkisë për vitin e parë, pastaj diskutime të tjera sesi mund të tërhiqen investitorët e huaj por që nuk ka lidhje me paketën fiskale mendoj se mbase mund ta lemë si pike tjetër. Kishte ndonjë propozim nga ana juaj për lehtësi fiskale që ne duhet t'ja u bëjmë investitorëve të huaj, më shumë se t'i përjashtojmë fare nuk e di se çfarë mund t'ju bëjmë?

Përsa i takon asaj kompanisë e cila ishte e interesuar për të hapur një prodhim të kabllove të makinave besoj duhet ta kem dhënë këtë informacion sepse është pak i vjetër si diskutim. Ne kemi marrë një komunikim zyrtar nga kompania e cila na ka informuar për shkak të ndryshimit të strategjisë apo situatës ndërkombëtare, kompania kishte vendosur ta shtynte në kohë deri në një moment të dytë projektin që kishin për të hapur këtë linjë të kabllove elektrike në qytetin e Korçës. Nuk jam në dijeni se ku mund ta kenë hapur këtë linjë në vendet rreth nesh, meqëse po flasim për punësim për banorët e Korçës në subjekte private më duhet ta them se jemi në situatën nga informacioni që kam që ka një numër subjektesh private ekzistuese që kërkojnë të punësojnë individë dhe nuk i gjejnë, kemi punëkërkuar që rregjistrohen kemi edhe biznese që kërkojnë njerëz por nuk i gjejnë. Patjetër duhet punuar paralelisht për të gjetur kompani me incentive apo forma të ndryshme të mbështetjes por besoj se ka hapësira punësimi në kompani private. Përsa i takon numrit të vizitorëve kemi statistika dhe këtu në Shqipëri për hir të së vërtetës është vështirë të kesh statistika të sakta pasi edhe bizneset nuk është se i deklarojnë 100 % të sakta por ne kemi një numër vizitorësh të marrë nga drejtoria e të ardhurave. Soni e ke për kollaj një numër?

Me ta marrë këtë si shifër do ja u japim por nuk e di si e lidhni këtë me paketën fiskale. Ne kemi një taksë të fjetjes në hotel e cila është taksë është e përcaktuar në sistemin e taksave vendore dhe nuk e di si e sygjeroni lidhjen midis paketës dhe numrit të vizitorëve. Gjithashtu doja pak më të detajuar si e shikoni lidhjen midis paketës fiskale dhe numrit të familjeve apo individëve që janë resident, çfarë politike duhet të ketë, ulje apo rritje të tarifave të familjeve?

Këto kisha si fillim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka kërkuar fjalën znj.Qeleshi.

Këshilltare M.Qeleshi: Në lidhje me paketën fiskale do cilësoja se paketa fiskale transparencën e ka element kryesor dhe mbështetet në marrjen parasysh të interesave për grupet përkatëse. Vërtet na tha

kryetari që nuk kanë ndryshuar taksat dhe tarifat dhe këto kanë disa vite nuk kanë ndryshuar por ne mund të gjykojmë nëse këto taksa dhe tarifa janë të bazuara dhe a janë në masa ndërkimë për qytetarët, për bizneset dhe gjithë subjektet e tjera që kryejnë aktivitet tregëtar apo janë ato meqënëse janë në vijë lineare ndër vite qëndrojnë?

Gjithsesi materiali ka bazën ligjore, relacionin ato strukturat përgjegjëse të vjeljes të detyrimeve, afatet e pagesës dhe tabela e tarifave dhe taksave që janë vetëm tabela, në thelb ky material nuk ka bazën sesi janë llogaritur kostot dhe ku është bazuar llogaritja për këto taksa dhe tarifa dhe kjo vetëm për efekt transparence, qoftë në mënyrë të përmbledhur sepse planifikimi i tyre normal që është një punë analitike por do ishte e rëndësishme që kur ta lexojnë të gjitha grupet e interesit të kishin një orientim të drejtë sesi janë llogaritur këto taksa dhe tarifa. Për taksat normalisht aplikohen në territorin që mbulon njësi, mungon kjo analizë e taksave qoftë edhe një përcaktim apo detajim me kategori, baza e taksueshme apo dhe aplikimi në kufij që jep ligji që çdo qytetar të gjykojë nëse ka taksim të drejtë apo jo. E njëjta gjë për tarifat megjithë elementët që përmenda për taksat, mungon përcaktimi i tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendoset.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal por po vazhdojmë pyetje dhe diskutime paralelisht?

Që do thotë nuk do e merrni më fjalën për diskutim sepse po bëni edhe komente lidhur me to, këtu e kisha fjalën.

Këshilltari M.Qeleshi: Më fal ju znj.kryetare thatë vazhdojmë me diskutimet dhe fillimisht e mori Lazjoni. Mos jam keqkuptuar?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë fillimisht e dhashë fjalën për pyetje, i bëtë pyetjet që kishit dhe unë thashë besoj se e keni gjetur përgjigjen brenda fjalës për diskutime. Tani jeni për diskutime?

Këshilltari M.Qeleshi: Jo nuk do e marr më fjalën, ju thatë kush e do fjalën për diskutime dhe e mori Lazjoni, domethënë dhe për tarifat mungon analiza e kostove sipas standarteve për sipas shërbimeve publike në mënyrë të përmbledhur. E njëjta gjë mungon argumentin ekonomik ku për bizneset, për familjet, për individët, për ndërtesat, për tokat buqësore pra gjithë elementët ku përcaktohet edhe paketa fiskale, mbi bazën e të cilave hartohet edhe buxheti, ndoshta do ishte më mirë që kjo paketë fiskale të kishte edhe një plan për zënien e hapësirës publike nëse e lejon ligji që të gjykohej edhe për këtë taksë që është shumë e rëndësishme. Unë po marr një rast në lidhje me tarifën e pastrimit e cila është 380 lekë për familjet kurse për bizneset është e ndryshme, nuk kemi një argument teknik se sa shkon vlera e pastrimit e cila ka një peshë të rëndësishme në buxhetin e Bashkisë. Sa shkon kostoja e depozitimit për 1 ton apo edhe shumë elementë të tjerë të cilat nuk mund t'i përmendim tani dhe nuk kemi një argument ekonomik sepse ne i strukturojmë në paketën fiskale bizneset sipas xhirove dhe një biznes i madh tarifohet njësoj por nuk mund t'i barazosh vetëm duke u mbështetur tek xhiroja për nivelin e produktit që nxjerrin, një biznes nxjerr pak produkt dhe një fabrike nxjerr shumë duke pasur të njëjtën xhiro brenda strukturës të nivelit të xhirove ne i barazojmë, ky nuk është tarifim i drejtë duhen edhe elementë të tjerë për të bërë diferencimin. E njëjta gjë do thoja edhe për familjet që ka vite që dsikutohet kjo që duhet të jetë me persona jo me familje ndoshta ka vështirësi është gjë tjetër kjo, ndoshta ndërkimë do e quaja unë mund të jem edhe gabim atë masën dy mujore të vjeljes të taksës të hapësirës publike sepse ka biznese me karakter shumë sezonal dhe brenda dy muajsh nuk mund të bëjnë të ardhura, mund të bëjnë vetëm periudhën e verës përshembull dhe janë në gjendje të shlyejnë detyrimet për periudhën tjetër, ky afati të ishte më i gjërë, nisur nga lloji i aktivitetit të karakterit sezonal. Ndoshta gjykimi sipas paketës fiskale thotë që për bizneset e reja do gjykohej niveli i tarifës nga

zyra, kjo më krijon subjektivizëm mund të jem edhe gabim. Ndoshta në paketën fiskale do ishte e mira të llogariteshin edhe kostot ekonomike por për taksat të krijohej ajo mundësia të merrej ajo hapësira ligjore minus 30 % që e ka tagër Këshilli Bashkiak dhe të lehtësoheshin meqënëse jemi në nivelin e ligjit. Vlerësoj gjithashtu që në paketën fiskale nuk janë parashikuar gjatë për sektorin veterinar që nuk është kompetencë e strukturave të njësisë vendore, për familjet jo efektive e dimë që janë shumica në emigracion dhe paguajnë tarifën pastrim, ndriçim, gjelbërim dhe mirëmbajtje varrezash publike. E para njëherë si mund të verifikohen por këto nuk e marrin gjatë vitit këtë shërbim ndoshta do ishte më e reduktuar pjesa e këtyre tarifave nëse këto do evidentoheshin është një punë e madhe por është sygjërim. Edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë është 8 % e ndarë në zonë është 8 % në zonën Ansambël, kjo është në nivelet e Tiranës ndoshta mund të ishte më e vogël nuk flas nëse është e argumentuar apo jo por duke qënë një nivel shumë i lartë për zonën Ansambël, kështu që mendoj se me këto sygjërim mund të ndërtoj një ambient fiskal shumë i lehtë dhe për të gjitha këto arsye vota ime është kundër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjërimet po kur të vijë votimi mund ta përmendni votën tuaj. Z.Fejzulla ka kërkuar fjalën.

Këshilltar E.Fejzulla: Do doja të përgëzoja faktin që nuk ka rritje në tarifën dhe taksat që janë parashikuar në këtë dokument dhe pse çmimet shkojnë në rritje ne kemi ruajtur të njëjtat taksa dhe tarifa. Doja të pyesja në lidhje me efektin financiar real që kanë këto ndryshime, a janë parashikuar në mbledhjen e tarifave në buxhet, sa është efekti real i tyre?

Ne mund të vendosim lehtësira fiskale të cilat nuk përdoren ose nuk shkojnë atje ku duhet dhe çfarë kuptimi ka që ne ta miratojmë?

Kjo ishte pyetje ime nëse do kemi diskutime më vonë, do marr fjalën për diskutim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jemi në momentin e pyetje-diskutime.

Këshilltar E.Fejzulla: Unë mendoj se ky relacion mbase duhet të kishte një analizë socio-ekonomike më të qartë ku mund të përmendej rritja e kostove, inflacioni i qirave, ndikimi i rritjes tek bizneset e vogla, dëmet e shumta që erdhën nga rreshjet e shiut që përjetuam ne, rritja e kostos të energjisë mund të ishin gjërat që ndoshta mund t'i kishim përmendur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Znj.Ada ka kërkuar fjalën.

Këshilltare A.Përmeti: Duke qënë si vit i tretë si këshilltare që ne miratojmë paketën fiskale, por edhe konsultimeve që bëmë në terren në të gjitha njësitë administrative dhe në rajonet, dokumenti këtë vit vjen më i përmirësuar duke qënë më i qartë çdo grup çfarë lehtësira kanë, çfarë pagesash dhe kush është lehtësia, unë e vlerësoj se cila nga departamentet apo drejtoritë është përgjegjëse për vjeljen e taksës dhe kjo na ndihmon ne apo banorët të cilët orientohen tek problematikat e tyre pa u sorollatur. Gjithashtu vlerësoj se sa më të detajuara të bëhen programet në sektorë të ndryshëm dhe lehtësirat që janë sjellë për këto grupe tek sipërmarrjet e vogla është shumë pozitive dhe kjo e ka shtuar këtë pjesën e lehtësive fiskale që janë për ata që quhen të rinjtë apo gratë, apo edhe pjesa e artizanatit që janë profesione që ne duam t'i rinovojmë për t'i përjashtuar nga këto tarifa për një periudhë të caktuar, këtë e përgëzoj në këtë pjesë edhe saktësimet e bëra për hapësirat publike apo edhe pjesa e gjithë bizneseve që e kanë me meritë pagesën pra Biznesi i vogël i cili është më i madh që ne kemi në Bashki ka përfitime në këtë pagesën e tarifave por edhe taksave, gjithashtu edhe saktësimet e bëra kur t'i ke një ambient që e përdorin dy biznese apo dy veta si e ke kodin ekonomik kjo ka bërë që dhe vjelja e taksave apo tarifave

të jetë në rritje për Bashkinë dhe të rrisë performancën e saj , duhet të kemi parasysh se sa më e rirtur të jetë performanca e Bashkisë aq më mirë është për Bashkinë tonë që ajo të thith fonde qoftë të buxhetit apo pjesëmarrje në pjesën e grandeve apo projekte të ndryshme sepse kjo tregon se banorët e Korçës e duan rregullin dhe kjo sjell zhvillim për komunitetin për të ardhmen e fëmijëve tanë që jetojnë këtu. Kam vetëm një këshillë për paketën e ardhshme në lidhje me pjesën e ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë unë do sygjeroj që janë me aktivitet ekonomik që lidhen në varësi të Bashkisë, qoftë SH.A apo SHPK mos përjashtohen nga tarifat sepse ato i përdorin këto shërbime, nga taksat po sepse janë të larta por duke qënë se gjenerojnë edhe mbeturina, ndriçimin urban sepse ato zhvillojnë aktivitet ekonomik.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltare A.Zheku: Kam një pyetje të vogël.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani i shteruem pyetjet, jemi tek diskutimet.

Këshilltare A.Zheku: Mbetën në mes edhe pyetjet, ose lind ndonjë pyetje gjatë diskutimit. Çfarë mekanizmi ndjek drejtorja e të ardhurave për verifikimin e familjeve jo efektive, a është bërë një përllogaritje sa do jetë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E tha znj.Qeleshi diçka të tillë nëse unë isha e vëmendshme.

Këshilltare A.Zheku: Nuk tha mekanizmin e evidentimit të familjeve jo efektive, dihet që emigracioni sa vjen edhe shtohet. A është bërë një përllogaritje sesi, duke qënë se nuk kemi një sistem që emigrantët të bëjnë një kërkesë online të mos prezencës të tyre në qytet, si do bëhet ky indetifikim dhe si do e përfitojnë ata çlirim nga kjo barrë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse e morët fjalën për pyetje, e doni edhe për diskutim?

Këshilltare A.Zheku: Jo.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Për procedurë edhe për efijence sipas rregullores e marrim fjalën vetëm njëherë për pyetje edhe diskutim sepse nëse vazhdojmë vazhdimisht ky diskutim zgjat pafund, prandaj janë rregulloret ku është e përcaktuar se secili këshilltar ka të drejtë të marr fjalën njëherë për pyetje edhe njëherë për diskutim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetar keni diçka?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Disa sqarime për pyetjet dhe diskutimet e mëparshme. Planifikimi i nivelit të tarifave kryesisht në raport me ato ç'ka ato mbulojnë. Si koncept tarifa aplikohet në sjkëmbim të një shërbimi që qytetarët marrin dhe si parim fondet që mbledhin duhet të jenë të barabartë me shpenzimet që ne kryejmë për atë shërbim. Për asnjë nga kategoritë pastrim, gjelbërim, ndriçim nuk është se jemi në pozicionin që mbledhim më tepër të ardhura nga tarifa që aplikojmë sesa janë shpenzimet që ne kryejmë për ofrimin e këtij shërbimi. Madje për ofrimin e shërbimit të gjelbërimit ky raport kosto-të ardhura është goxha i pabalancuar në raport me kostot ato janë goxha të mëdha në raport me të ardhurat që mbledhim nga tarifat. Tarifa e pastrimit ne jemi në një proces diskuimi në kuadrin e një projekti që mbështet nga Bashki të Forta për të parë rishikimin e mbledhjes të tarifës të pastrimit qoftë për familjet, qoftë për institucionet dhe pjesa e diskutimeve deri tani është edhe mbase mundësia e aplikimit e një mënyre tjetër e mbledhjes të tarifave jo mbi bazë familjesh siç e kemi sot po mbi bazë individësh, jo një familje që ka 2 anëtarë të paguajë njësoj si ajo familje që ka 4 por do shohim ecurinë. Përsa i takon taksës të ndërtesës është e vërtetë që për pjesën e ndërtimeve që kryhen nga

subjekte private me qëllim shitje në Ansambël kemi masën 8 % që është maksimumi që parashikon ligji por është gjithashtu e vërtet që në gjithë pjesën tjetër të qytetit ne aplikojmë taksën e ndikimit në infrastrukturë për qëllime private me qëllim shitje 4 % dhe kjo 4 % është minimum i taksës të ndikimit në infrastrukturë. Në lidhje me efektin financiar unë e thashë ai vlerësimi paraprak që kemi nga viti aktual është që lehtësirat që ne propozojmë kanë një ndikim në buxhet në masën 30 milion të reja, Përsa i përket metodologjisë që përdroim për indentifikimin e familjeve jo efektive mund ta sqarojë Soni.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore S.Prifti: Përhëndetje, në lidhje me mënyrën sesi ne evidentojmë këto familje, përfitojmë nga informacioni që na vjen nga rajonet administrative nga kryeqendrat dhe ata persona që vijnë tek sportelet tona ju kërkojmë vërtetim nga drejtorja e përgjithshme e kufirit, vetëm duke pasur këto dokumenta ne i klasifikojmë familje jo efektive.

Këshilltari A.Zheku: Ka që jetojnë në Amerikë, në Greqi.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore S.Prifti: Teems ka një datë dalje nga Republika e Shqipërisë dhe nëqoftëse ata nuk janë në Bashkinë Korçë më shumë se 165 ditë konsiderohen familje jo efektive.

Këshilltari A.Zheku: Duhet personi që të deklarojë dhe të bëjë kërkesën.

Këshilltari M.Qeleshi: Doja të thoja diçka, meqenëse mu përgjigj kryetari.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Njëherë merret fjala për diskutim se po vazhduam kështu, mund të mos jemi dakort me fjalën e kryetarit por kjo nuk do të thotë se duhet ta marrim fjalën na 20 herë

Këshilltari L.Petri: Në përgjigje të fjalës të z.kryetar do thoja sigurisht që vlen të kemi të dhëna të sakta të popullsisë dhe vizitorëve sepse këtu dalim në vizionin e metodës që përdorim ne për paketën fiskale të qënësishme. Nëse ne do tregojmë mençuri që të tarifojmë për shërbimin transportin publik, vizitorin gjatë asaj periudhe që kemi vizitorë dhe me këto të ardhura të lehtësojmë barrën fiskale të target grupeve mendoj se ka një dobi. Unë i bëra ato pyetje sepse e shoh paketën fiskale jo vetëm në raport me buxhetin por edhe me drejtësinë sociale. Ne shkojmë fshatrat ku ka lumenj e përenj të ndotur, unë jam një subjekt në fshatin x që e keqtrajtoj mjedisin që është pronë publike. Mos vallë duhet ta shohim edhe në këtë drejtim që të penalizohet unë që sillem keq dhe të gëzosh ti që sillesh mirë një shërbim ekstra?

Mund t'ja u dërgoj me shkrim z.kryetar por unë po e prek në parim sot.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal sepse ky është momenti sepse e dërguara me shkirm më vonë nuk ka asnjë efekt nëse ne e miratojmë sot paketën fiskale dhe ngelet për paketën e vitit tjetër. Përsa i takon implemtimit që biznese të caktuara kanë në mjedis qofshin përrenj, lumenj rreth e rrotull, paketa fiskale ka atë pjesën e tarifës që biznesi duhet të paguajë dhe është marrë parasyh implemtimi kryesor që një biznes ka në mjedis, në rast se një biznes i caktuar shkel legjislacionin në fuqi dhe shkakton ndotjen e mjedisit nuk jemi në kuadrin e paketës fiskale, jemi në kuadrin e gjobave që i vendoset subjektit nga Bashkia përsa i takon Bashkisë dhe nga IKMT-të që kontrollojnë sjelljen e subjekteve në raport me mjedisin. Përsa i takon tarifës të pastrimit apo çfarëdolloj tarife keni një propozim konkret, që mund ta diskutojë Këshilli?

Mënyra sesi mund të vilet një tarifë e caktuar, një nga parimet e paketave fiskale është të jenë të kuptueshme dhe lehtësisht të menaxhimit nga ana e administratës fiskale në rast se ne lejmë një metodikë apo mënyrë të mbledhjes të një tarife që është shumë e komplikuar, rrezikojmë që ta

komplikojmë si system dhe efekti është të mbledhim më pak të ardhura. Në rast se keni ndonjë propozim është momenti ta thoni tani sepse gjatë nuk bëjmë dot ndryshime tek paketa fiskale.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për z.Tollkuçi.

Këshilltar P.Tollkuçi: Të nderuar kolegë, sigurisht që ne ekmi thënë edhe herë të tjera që gjithë këshilltarët janë të lirë të vijnë në çdo mbledhje komisioni dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me gjitha projekt vendimet që dikutohen atje. Në asnjë moment nuk i është ndaluar askujt të jape mendimin e tij, mund të kemi edhe ne eksperiencia pozitive lidhur me çdo fushë të jetës dhe ato projekt vendime që ne kemi për të miratuar dhe në këtë rast e mbështes kryetarin e Bashkisë lidhur me atë që thotë. Sigurisht vijmë këtu për të diskutuar qoftë edhe politikisht dhe shumë e drejtë por ama të vijmë me gjëra konkrete. Lidhur me paktën fiskale unë mendoj se ajo është në vazhden e miratimit apo hartimit të saj bazuar mbi ata faktorë të cilët janë në Bashkinë e Korçës, kjo për kohën që unë kam qënë drejtor i taksave në Bashki i përket një kohe shumë më parë mbi 12 vjet, kështu që unë kam qënë pjesëmarrës dhe e di si hartohet një paketë fiskale. Vërtet mund të mos kemi sot dokumenta bashkëngjitur sesi është hartuar por vitin e kaluar ne kemi pasur një pasqyrë të tillë se ton mbeturina prodhohet përshembull për tarifen e pastrimit sa nga biznesi dhe sa nga familjet apo edhe me pjesën e tarifave të tjera gjelbërim, ndriçim ne jemi të pranishëm dhe shohim një fakt që për vit rriten hapësirat që ndriçohen, gjelbërohen dhe pastrohen dhe kjo ka një kosto dhe duke u rritur kërkesat e njerëzve që janë mëse të drejta sepse kërkojnë më shumë shërbime dhe janë taksapagues të rregullt, duke qënë se ky shërbim po rritet Bashkia po mban një barrë më tepër duke rritur shërbimin dhe jo tarifat, kjo është për tu vlerësuar dhe gjitha lehtësitë që ajo ka. Kjo paketë synon të lehtësojë zhvillimin e biznesit, jo vetëm biznesit të vogël por edhe të madhit, kjo përkrah gjithë të drejtat sociale kështu që nuk na ngelet gjë tjetër që kësaj pakete t'i japim miratimin dhe Bashkia e saj të vazhdojë punën për vitin 2026 pasi pa një paketë fiskale ne do kemi një kolaps jo vetëm për Bashkinë Korçë por edhe gjithë njësive vendore, unë ju ftoj edhe njëherë ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 22 pro, 5 kundër, 0 abstanim.

Pika 10 e rendit të ditës.

“ PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË GODINËS KU USHTRON AKTIVITETIN DREJTROIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË, ME NR. 4/33- ND3 PASURIE, ME SIPËRFAQE 1400 M2”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse në dijeninë time komisioni nuk ka arritur kourumin e duhur, do doja nga drejtoria juridike një përmbledhje dhe sqarim për këshilltarët.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Bëhet fjalë për dhënien me huapërdorje të godinës ku aktualisht zhvillon aktivitetin drejtoria rajonale e ofrimit të formimit profesional publik. Me këtë drejtori kemi pasur më parë edhe dy kontrata të tjera huapërdorje njëra ka qënë me afat 6-mujor dhe tjetra 1-vjeçar, të dyja këto kanë përfunduar afatin e tyre dhe propozohet të jepet me një afat tjetër 1-vjeçar me huapërdorje pa kundërshtpërblime me qëllim ushtrimin e aktivitetit nga ana e kësaj drejtorie.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka ndonjë pyetje?

Besoje se këtë e kemi ezauruar edhe vitin e kaluar. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

“ PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË PASURISË ME SIPËRFAQE 2430 M2, PASURI E LLOJIT TRUALL ME NR. 1/861 ZK 8561, PËR QËLLIME ZHVILLIMI AKTIVITETI EKONOMIK”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Gjithashtu për komisionin juridik vlen e njëjta, ju lutem një sqarim edhe për këtë pikë.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Sipërfaqja e truallit prej 2430 M2 aktualisht po përdoret nga një subjekt dhe bëhet fjalë për këndin e lojrave në fund të parkut, meqënëse kjo kontratë përfundon në datën 31 dhjetor ne propozojmë që të fillojë edhe njëherë procedura për ta dhënë me qira këtë pasuri. Afati që propozhet është për 1 vit dhe tarifa për m2 është sipas vendimit të Këshillit të Ministrave është 25 lekë për m2, i propozojmë Këshillit të lejojë Bashkinë për zhvillimin e konkursit për këtë sipërfaqe.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar L.Petri: U shqyrtua nga komisioni mundësia që kohështrirja të jetë për tre vjet?

Sepse parë nga këndvështrimi i një sipërmarrësi një vit është një kohë relativisht e shkurtër për të bërë një investim edhe të marrësh një risk për të cilin nuk i dihet ecuria.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Siç e thashë edhe më parë për shkak të mungesës të kourumit nuk munda të japë një mendim të tij ndaj edhe unë ftova ekzekutivin për të dhënë një përmbledhje për këtë pikë të rendit të ditës. Nëse e keni pyetjen lidhur me ekzekutivin mund ta bëni.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Sipas ligjit dhe vendimit të Këshillit të Ministratve lejohet afati 3-vjeçar por propozimi ynë është për një vit me argumentin se mund të përdoret për ndonjë interes publik.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është që nuk është një kontratë që ne po e lidhim për herë të parë, ne e kemi lidhur para shumë vitesh që kur u bë rikonstruksioni i Parkut Rinia, nuk jemi në kushtet që po bëjmë kontratë 1-vjeçare ku subjekti do bëjë investimin edhe nuk i di të ardhmen. Është një periudhë e gjatë ku ne e kemi dhënë disa herë me qira dhe kemi gjykuar që këto herët e fundit afati i qiradhënies të jetë 1-vjeçar për t'i krijuar mundësinë Bashkisë që të ketë një lloj fleksibiliteti në rast se do ketë një projekt zhvillimor të ndryshëm tek ajo zone, kjo është ideja.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Pika 12 e rendit të ditës.

“PËR NDRYSHIMIN E LLOJIT TË TRANSFERIMIT NGA PËRDORIMI NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË TOKAVE QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE) ME NR PASURIE 1100, NR.629, NR. 635, NR.636, NR. 751, NR.754, NR.755, NR.757, NR.765, NR.790, NR.791, NR.965, NR.1074, NR.1075, NR.1076, NR.1080, NR.1081, NR.1091, ZK 1631 ME VENDNDODHJE NË FLOQ, NJA MOLLAJ SI DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË TOKAVE QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E PYJEVE DHE KULLOTAVE PASURITË ME NR.1345, NR.1383, NR.1347, NR.992, NR.977, NR.739, NR.976, NR.781, NR. 767 ZK.1631 ME VENDNODHJE NË ROSHANJ, NJA VITHKUQ SIPAS GENPLANEVE BASHKNGJITUR”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem drejtoria juridike një sqarim të plotë për ta kuptuar këshilltarët.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Tokat buqësore nuk kanë kaluar në pronësi të Bashkisë por në përdorim, në kuadër të ligjit 20 të vitit 2020 për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë jemi duke bërë një përmirësim të listave të inventarit të pronave dhe tokat buqësore që rezultojnë të pandara dhe gjatë verifikimeve që ne bëjmë në terren në mënyrë të vazhdueshme edhe në mbledhjet e ardhshme do i paraqesim që të na ndryshojë mënyra e transferimit nga përdorim të na transferohen në pronësi, në këtë fazë kemi arritur të evidentojmë këto toka buqësore me nurrat përkatës tek njësitë administrative Mollaj ndërkohë që është dhe një pjesë tjetër pasurish që nuk janë me zërin kadastral tokë buqësore por pyje, ato kanë kaluar në pronësi të Bashkive por këto pasuri që përmenden kanë ngelur jashtë listës të pyjeve. Me këtë material kërkojmë kalimin e tokave buqësore

nga përdorim në pronësi dhe kalimin në pronësi të disa sipërfaqeve pyjore të cilat i keni të detajuara në material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar A.Habip: Pyetja ime është nëse ka akoma toka të cilat Bashkia ka akoma për t'i kthyer në pronësi nga përdorim në njësitë e tjera administrative dhe e dyta a ka pasur problematika të kontestimit nga banorët e njësive administrative, nisur edhe nga problematika që ndodhi në Bashkinë e Pogradecit?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Në lidhje me pyetjen e parë thashë që po ka toka buqësore te pa evidentuara dhe do i sjellim vazhdimisht edhe në mbledhjet e ardhshme. Për rastin konkret nuk kemi problem me banorët. Në ASHK ka rezultuar që nuk ka akte të marrjes të tokës në pronësi për këto prona dhe në këtë mënyrë kemi vazhduar me kërkesën tonë për të kaluar në pronësi të Bashkisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 13 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKISË KORÇË DHE AGJENSISË SHETETËRORE TË KADASTRËS”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem drejtorja juridike një sqarim.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Aktualisht kemi një marrëveshje me ASHK me qëllim përfundimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet të zhvillimit urban, kësaj marrëveshje i ka kaluar afati dhe propozohet të lidhim një marrëveshje tjetër deri në vitin 2028. Në bazë të kësaj marrëveshje ajo që ka marrë përsipër Bashkia është që ne të vendosim në dispozicion të ASHK punojës të Bashkisë për të ndihmuar ASHK në këtë process, në zonat e zhvillimit urban.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 14 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT CROSS-MOVE- CROSS BORDER SUSTAINABLE MOBILITY EFFORTS IN THE SOUTH-ADRIATIC ARES” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Bëhet fjalë për projektin Cross- Move që është pjesë e marrëveshjes të gjelbër të Bashkimit Europian, ky projekt mbështet Bashkitë e vogla të shteteve të Italisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë, ky projekt i cili ka burime financimi 85 % nga BE dhe 15 % nga kontributet e Bashkisë, vlera është 3 milion e 360 mijë e 057 lekë i cili do vetëm kontribut në natyrë, pjesa tjetër 22 milion e 400 mijë e 388 lekë që është kontributi i BE, komisioni vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim, është një nga disa projekte për tu vlerësuar që Bashkia është përfituese.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Sikur të kishim sa më shumë projekte të tilla me bashkëfinancim.

Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Fejzullah: Përsa i përket projektit ka diçka konkrete?

Sepse këtu nuk thuhet asgjë në relacion.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është një projekt siç e tha edhe Altini ne e kemi fituar nga programi triateral quhet, kemi fituar në fushën e mobilitetit, prashikohet të bëhet një plan i lëvizshmërisë me gjithë komponentët e tij dhe me pasjen e dokumentit strategjik sepse tani nuk e kemi bazuar edhe me gjetjet e tij, të kemi mundësinë të orientjmë edhe politikat edhe projektet edhe investimet tek këto fusha edhe 1 komponent që e ka fizik që është vendosja e dy semaforëve në dy pikat e qytetit ne e kemi propozuar pjesën e unazës të qyteti, kryqëzimi me dritat e verdha dhe një pjesë tjetër. Këto janë pjesë e investimit po e quaj dhe pjesa tjetër është pjesa e hartimit të planit të mobilitetit, mund të ketë edhe aktivitete të tjera në kuadër të projektit por dy më kyesoret janë ato që unë thashë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 15 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “DIU – DIGITAL INNOVATION UNIT” NË KUADËR TË THIRRJES DIGITAL 2023- EDIH- 04 SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe për këtë një koment të shkurtër nga komisioni.

Këshilltar A.Habip: Edhe ky projekt fitues synon të krijojë në Shqipëri një ekosistem të qëndrueshëm dhe konkurues digjital duke mbështetur transformimin dixhital. Përbëhet nga Bashkitë Korçë- Tiranë dhe universitetet dhe kompanitë private. Ky projekt do të krijojë trajnime të avancuara dixhitale për stafet teknike dhe menaxheriale si dhe aktivitete rijetëzimi për avancime dhe bashkëpunim. Vlera e këtij projekti përfitues është 2 milion 012 mijë e 600 lekë i cili është 100 % kontribut i BE.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare A.Zheku: Kam një pyetje të shkurtër, duke qënë se ky projekt i dedikohet familjeve, a do ketë transparencë në mënyrën e përzgjedhjes se cilët kalifikohen për të qënë pjesë e këtij projekti?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Si rregull Këshilli mund të kërkojë informacion për çdo projekt përfshirë edhe këtë.

Këshilltare A.Zheku: Nëse kanë të drejtë studentët të marrin pjesë, a do informohen?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do informohen patjetër, prandaj është bashkëpunim me universitetin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë nuk e kam listën para të por si rregull, çdo projekt ka sesione informimi siç ka qënë më parë, pra bëhen sesione informuese për çdo grup edhe sikur mos duam ne BE e ka pjesë të metodologjisë informimin por edhe ne duam, nuk e kam listën këtu por patjetër duhet të jetë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 16 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KALENDARIT TË AKTIVITETEVE 2026 DHE PLANIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE 2026 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se plani është i qartë, nëse keni ndonjë sygjërim në lidhje me planin mund të na i thoni por mund të ndryshohet edhe gjatë vitit. Mendoj ta hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është e hapur nëse ka ndonjë sygjërim për aktivitetet e Këshillit të na i thoni. Në pika të ndryshme doja të ndalesha tek pika e parë që kërkoi z.Osmani. Unë ju bëj me dije se në mbledhjen e kryesisë edhe me propozim të opozitës meqënëse z.Osmani ka kërkuar të tërhiqet nga komisioni i financave duke propozuar znj.Mirela Qeleshi për të qënë pjesë e këtj komisioni të buxhetit dhe financave. Ne jemi dakortësuar të zvendësojë znj.Mirela z.Osmani dhe z.Osmani të zvendësojë atë tek komisioni i buqësisë, pyjeve dhe kullotave. Besoj se kemi dakortësinë e gjithë këshilltarëve dhe t'i vendosim të zbardhura në komisione. Sekretaria t'i lexojë edhe njëherë.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Popozimi është sepse duhet ta hedhim në votim, znj.Mirela Qeleshi të zvendësojë z.Devis Osmani si anëtare e komisionit të financave dhe z. Devis Osmani të zvendësojë znj. Mirela Qeleshi tek komisioni i menaxhimit të pyjeve, mbrojtjes të mjedisit dhe biodiversitetit. Znj. Mirela Qeleshi do jetë pjesë e komisionit të financave, komisionit të ligjeve dhe titujve të nderit. Z.Devis Osmani që ka paraqitur dorëheqjen do jetë pjesë e komisionit të pyjeve, buqësisë. Këto ndryshime do i hedhim në votim dhe unë do zbardh një vendim sipas saj.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jam informuar se ka disa qytetarë që edhe pse nuk kanë dorëzuar kërkesën me shkrim, kanë qënë prezent në mbledhjen e Këshillit që në fillim dhe na kanë pritur ne. Kush e do fjalën për të shprehur problematikat tuaja sepse ne nuk e kemi idenë?

Qytetari: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do më prisni pak, hajdeni në zyrë të vijë edhe ky inspektori i inspektoriatit, tani po them. Kemi folur edhe njëherë bashkë por nuk e mbaj mend si rast, më prisni tek zyra të vijë edhe inspektori të na shpjegojë edhe njëherë rastin sepse mund të jetë diçka që mund të mos e zgjidhim ne.

Tek zyra ime do vijë inspektori edhe ky topografi jonë dhe të na i thonë çfarë kanë gjetur dhe të na thonë bëhet apo nuk bëhet.

Qytetari: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Vjollca ju kishit dy kërkesa. E para të shpronësohen ato familje që kanë ngushtuar rrugën dhe e dyta ishte të asfaltohet rruga. Tani pa u liruar nuk mund të asfaltohet, në dijeninë time e kemi bërë kërkesën përshpronësim, ta verifikojmë. Pa u shpronësuar nuk bëjmë dot.

Qytetari: Po sa zgjat kjo, të paktën këtë vit do bëhet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E para duhet bërë procedura e shpronësimit dhe e dyta pastaj të investohet sepse nuk bëjmë investime me "ripka". Procedurën e shpronësimit nuk e bëjmë ne, bëhet me vendim Qeverie, të marr informacion deri ku jemi edhe do ju njoftoj.

Këshilltat L.Petri: Zonja ka erdhur edhe më parë edhe me thënë të vërtetën cilësia e Këshillit nuk del mirë tek kjo gjë që qytetarët zvariten edhe vijnë herë pas here. Sigurisht çështjet marrin kohë duhet të jemi të durueshëm. Nga ana tjetër mendoj se duhet ngritur një grup pune dhe të mbikëqyrë punët dhe të sqarojë gjërat me zonjën nuk ka pse zonja të vijë këtu, ne nuk i japim dot zgjidhje kjo është ideja.

Qytetari: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal sepse mënyra i po ma kërkon duket sikur situata ka erdhur për shkak të lejava të ndërtimit që ka dhënë Bashkia dhe jo për shkak të ndërtimeve joformale që kanë bërë sepse situata në atë zonë ka erdhur për shkak të ndërtimeve pa leje.

Qytetari: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk është vetë asfaltim, duhet shpronësuar rruga. Edhe njëherë situata në atë zonë është për shkak të ndërtimeve pa leje nga vetë banorët dhe për shkak të ligjit që thotë legalizim pastaj urbanizim, urbanizimi do të thotë duhet të bëjmë shpronësim të hapësirave të rrethuara me gardhe, pa lejen e Bashkisë, nuk i kam bërë unë me firmën time. Po nuk bëjmë shpronësim nuk bëjmë dot investim. Për të erdhur tek pjesa e investimeve nuk është se ne presim që të vijnë tek mbledhja e Këshillit dhe të investojmë sepse këtu mund të vijnë në një moment gjithë banorë të fshatrave që kanë rrugë të pa asfaltuara e do i bëjmë për një vit, nuk është e mundur. E nderuar këshilltare znj.Qeleshi nuk është se erdhën banorët edhe menjëherë do bëhet rruga sepse ka edhe lekë edhe buxhete që duhen alokuar. Nuk na mungon dëshira për t'i bërë për 1 muaj apo për 1 vit. Sa i takon emergjencës sa herë ka erdhur qytetaria dhe pa erdhur qytetaria, mirëmbajtjen periodike me Ndërmarrjen me çakullimin e rrugës e kemi bërë sa herë kanë thënë, por rrugë me çakull nuk është vetëm e zonjës në Bashkinë Korçë të jemi koshientë. Të gjithë kanë të drejtë të kërkojnë asfaltimin por mundësitë janë ato që i shohim së bashku në buxhet nuk është se më mungon mua dëshira të bëj rrugën e Vjollcës.

Qytetari: Taksat i paguaj të gjitha.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Emergjencë është zgjerimi i rrugës që lidhet me shpronësimin. Pjesa e mirëmbajtjes është periodike derisa t'i vijë rradha asfaltimit, sa më shpejt aq më mirë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit. Mirë u takofshim mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL**RELACION*****MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR,
PËR PERIUDHËN 1 – 30 NËNTOR 2025***

Për muajin **Nëntor**, janë **59** familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, **“Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”**. Përzgjedhja bëhet bazuar kritereve të miratuara me VKB, nëpërmjet vizitave në familje në terren dhe duke verifikuar gjendjen social-ekonomike të familjeve aplikante, sipas ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” të Udhëzimeve nr. 3,4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”. VKB Nr.176, datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë, udhëzimin plotësues Nr.2, datë 24.01.2025, për zbatimin e buxhetit të vitit 2025. Vendimit nr. 4 dhe 5, datë 30.01.2025, të Këshillit Bashkiak Korçë **“Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, dhe nga fondi i buxhetit vendor i Bashkisë Korçë.**

Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kritereve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 4 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.5 për kriteret e 6%, datë 30.01.2025.

Për të gjitha këto arsye, Drejtoria e Kujdesit Social, i propozojnë Këshillit të Bashkisë:

- 1- Për muajin **Nëntor** është në dispozicion fondi prej **218.310 lekë** si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit.
- 2- **Nga ky fond, përfitojnë 59 familje**, të përzgjedhura sipas kritereve specifike të miratuara, në shumën **191.178 lekë**.
- 3- Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike **22 familje**, në shumën **27.040 lekë**.

4- Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është **218.218 lekë**.

5- Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i buxhetit vendor**, sipas kriterëve specifike të miratuara **10 familje**, me fond prej **55.588 lekë**.

Bazuar në Vendimet e mësipërme, përfituesit e kësaj kategorie, për zgjidhen kryesisht nga familjet e evidentuara nga administratorët socialë në nevojë ekstreme ekonomike dhe në kushte specifike sociale, pavarësisht cilësimit të sistemit elektronik të përzgjedhjes.

Persona të vetmuar	<u>4</u>
Persona në pamundësi fizike për të punuar	<u>1</u>
Kryefamiljare femra me fëmijë të mitur në ngarkim	<u>3</u>
Familje të komunitetit rom-egjiptian, me probleme social-ekonomike	<u>2</u>

Ky fond është parashikuar si 6 % nga fondi i kushtëzuar, për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor, i miratuar me VKB nr. 4 dhe 5 , datë 30.01.2025.

Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që dalin nga skema e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E DALJES NGA SKEMA	RAJONI/NJËSIA
1.	Majlinda	Çoban	Mali	Nuk u paraqit	Rajoni.1
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					

Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që rifuten në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E RIFUTJES NË SKEMË	RAJONI/NJËSIA
1.	Sanije	Shaban	Selman	Rifutje pas riaplikimit në sistem	Rajoni.3
2.	Alma	Vasfi	Iljas	Rifutje pas riaplikimit në sistem	Rajoni.2
3.	Mimoza	Baki	Ogreni	Rifutje pas riaplikimit në sistem	Mollaj
4.	Shkëlqim	Muharem	Sulollari	Rifutje pas riaplikimit në sistem	Bulgarec
5.					

Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që futen për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E FUTJES NË SKEMË	RAJONI/NJËSIA
1.	Skënder	Syrja	Karollari	Kryefamiljar i vetmuar	Drenovë
2.					
3.					
4.					

*Drejtores e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Drejtores e Kujdesit Social

*Drejtores e Financës,
Buxhetit dhe MFK*

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Mariana Jorgji

Valbona Ziko

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV. KRYETARE

Benila THEMELI

Bordero fondi 6% muaji Nëntor 2025

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	NID	Kategoria	Vlera e përlogaritur	Kompensimi i energjisë	Totali	Njesia Adm
1	Nuri	Ismail	Myrteza	G30707018V	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Drenove
2	Zugrafi	Thoma	Shkurti	G45223017U	Familjet në	3146	1288	4,434.00	Drenovë
3	Mimoza	Petra	Xega	G66118012C	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Drenovë
4	Zerdeli	Pasho	Llapanji	G15829067I	Familjet në	3146		3,146.00	Drenovë
5	Fatmira	Haxhi	Muka	G75904050N	Familjet në	3703		3,703.00	Drenovë
6	Thimaq	Petrika	Baka	I25323011V	Familjet në	5881	1288	7,169.00	Drenovë
7	Flutur	Amdi	Kallo	H16124043L	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.3
8	Nesti	Mynir	Trebicka	G20426078K	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.2
9	Diana	Hekuran	Zhuleku	G85524039W	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.3
10	Kristi	Petro	Lluka	I70917088R	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni.2
11	Alma	Vasfi	Iljas	H15409072C	Familjet në	1525		1,525.00	Rajoni.2
12	Pavlina	Nesti	Janko	G41011028H	Familjet në	3146	1288	4,434.00	Rajoni.3
13	Majlinda	Shaban	Hyseni	G85620121J	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni.3
14	Marjana	Nezhdet	Rahmani	H85421095P	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni.3
15	Majlinda	Sulejman	Bedulla	H05723057O	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni.3
16	Dino	Abdullah	Horanlli	G20528079I	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni.3
17	Vasil	Thomaq	Shkodrani	G40401133J	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
18	Gjergji	Vangjel	Lulo	I00105067T	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
19	Sanije	Shaban	Selman	G85803073V	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.3
20	Marina	Sotir	Zisiadis	G95419024R	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.2
21	Sotiraq	Qirjako	Koti	G61006101I	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
22	Zhuljeta	Josif	Mihali	G45711052J	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni 1
23	Gazmend	Selami	Kanina	G41126047W	Familjet në	2178	640	2,818.00	Rajoni 1
24	Nurije	Nevrus	Qenam	G55719062L	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni.2
25	Jorgjeta	Todi	Rapo	G65411179J	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.2
26	Spiro	Fasfi	Nazifi	H30221078E	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni.2
27	Natasha	Kosta	Lubonja	F65803047G	Familjet në	5720	1288	7,008.00	Rajoni 1
28	Marinela	Dritan	Gaqollari	H65606066A	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni 1
29	Edlira	Xhevair	Qazim	H26113050J	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
30	Renata	Bajram	Muka	G85708085U	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni 1
31	Sotiraq	Koço	Kondili	G10129161E	Familjet në	2178	1288	3,466.00	Rajoni 1
32	Rajmonda	Gurali	Kodra	G45612161Q	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni 1
33	Rolanda	Kësmet	Shahu	G153227081S	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni 1
34	Perika	Jani	Spitjani	G30324097E	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
35	Lambri	Paskal	Nauni	G40920086L	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
36	Marjana	Stavri	Janaq	G55529050J	Familjet në	3146	1288	4,434.00	Rajoni 1
37	Tonin	Pllumb	Dodaj	G10411066D	Familjet në	2178	640	2,818.00	Rajoni 1
38	Marjanke	Andrea	Miho	G65220152B	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
39	Sabike	Xhemali	Mustafaj	G66231042W	Familjet në	2178		2,178.00	Rajoni 1
40	Kostika	Llazi	Andon	H00530075I	Familjet në	3703		3,703.00	Rajoni 1
41	Morena	Enver	Bejko	I35714088C	Familjet në	5940		5,940.00	Rajoni 1
42	Olivera	Thoma	Simaku	I06210062T	Familjet në	8712		8,712.00	Rajoni 1
43	Rajmonda	Ajredin	Banushi	F85810082I	Familjet në	5720	1288	7,008.00	Rajoni 1
44	Eftjola	Robert	Tasellari	I55430119R	Familjet në	7920		7,920.00	Rajoni 1
45	Mirela	Panajot	Stillo	G56208048A	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni 1
46	Valentina	Nasho	Koraqi	G16202157R	Familjet në	3146		3,146.00	Rajoni.2
47	Adelina	Ndreçi	Kacori	F75208060S	Familjet në	5720		5,720.00	Rajoni.2
48	Vera	Xhelil	Sulejmani	H55303043G	Familjet në	3703		3,703.00	Mollaj
49	Albana	Skender	Shkemi	H56023069A	Familjet në	5940	1288	7,228.00	Mollaj
50	Lindita	Muharem	Qelemeni	G95810130L	Familjet në	3703	1288	4,991.00	Mollaj
51	Emanuela	Ramadan	Pelivani	J66227075E	Familjet në	9900		9,900.00	Mollaj
52	Mimoza	Baki	Ogreni	G46213022I	Familjet në	3146		3,146.00	Mollaj
53	Agron	Kareman	Jakllari	G10602009P	Familjet në	2178		2,178.00	Bulgarec
54	Elvira	Qamil	Dhosi	G75328114K	Familjet në	2178		2,178.00	Vithkuq
55	Sulltanë	Sako	Hime	G65325154W	Familjet në	2178		2,178.00	Vithkuq
56	Petrika	Kostandin	Nikolla	H2092036D	Familjet në	2178		2,178.00	Vithkuq
57	Dashnore	Isa	Golka	G16007114H	Familjet në	3146		3,146.00	Voskop
58	Shpresa	Rakip	Indrisllari	H65701012D	Familjet në	5940		5,940.00	Voskop
59	Diana	Çelnik	Zeneli	G85112015T	Familjet në	2178		2,178.00	Voskop
Totali						191.178	27040	218,218.00	

DREJTORI
Mariana Jorgji

LISTA E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN NËNTOR 2025
NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR.

Nr	EMER	ATËSI	MBIEMËR	Pagesa Mujore	Njësia Administrative	Arsyet e Trajtimit	ID
1	VASFIJE	P	NAZIFI	3703	RAJONI.2	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	G16229058Q
2	SOTIR	GJ	GROZDANI	5228	VITHKUQ	Familje ne kushte te veshtira ekonomike	G20412093G
3	MIGENA	Y	SHKËMBI	5228	MOLLAJ	Familje ne kushte te veshtira ekonomike	I55929095W
4	MONDA	Q	ALLISHA	3703	DRENOVË	Familje ne kushte te veshtira ekonomike	H55511033W
5	BRUNILDA	B	NAMETI	7920	DRENOVË	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	I86026056L
6	EMANUELA	V	KAREJMAN	3960	VOSKOP	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	J75415025G
7	SKËNDER	S	KAROLLARI	2178	DRENOVË	K/Familjar i vetmuar	H61103013S
8	SHKËLQIM	M	SULLOLLARI	2178	BULGAREC	K/Familjar i vetmuar	G50612029O
9	MANJOLA	B	RUSHAN	19312	RAJONI.3	K/Familjare grua, me shumë femije ne ngarkim	I55304106O
10	SPARTAK	A	LLOSHI	2178	RAJONI.3	K/Familjar i vetmuar	I10210108U
	TOTALI			55,588			

DREJTORI
Mariana Jorgji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2025

**Për miratimin e dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-
Ndihmën Ekonomike
dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-30 /11/2025 .**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025". VKB Nr.176, datë 26.12.2024, "Mbi Miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë", udhëzimin plotësues Nr.2, datë 24.01.2025, për zbatimin e buxhetit të vitit 2025. Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Korçë, **"Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë .**

Në lidhje me pagesat e Ndhmës Ekonomike për muajin **Nëntor 2025**, sipas propozimit të Drejtorisë së Kujdesit Social :

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

